



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr 21 datë 27/07/2016

**Për miratimin e pjesëmarrjes në projektet që do të aplikohen në thirrjen e dytë për projekt propozime - Programi Interreg IPA II CBC Greqi-Shqipëri 2014-2020:**

Këshilli i Qarku Vlorë, i mbledhur sot më dt 27 / 07 / 2016 në zbatim të nenit 34 dhe nenit 77. Të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe udhëzimit Nr.8, pika 3 të Ministrisë së Financave datë 17.02.2003 “Për evidentimit, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financave të huaja” pasi mori në shqyrtim projektet e paraqitur nga Kabineti dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve:

**Vendosi:**

- 1- Të miratojë përfshirjen në projektet :
  - a) **“Rritja e aftësive për menaxhimin e katastrofave natyrore nëpërmjet teknologjive SMART”**, në partneritet me: Universitetin Jonian, Qarkun e Ishujve Joniane, Prefekturën e Qarkut Vlorë, Universitetin e Gjeologjisë, Tiranë, me një buxhet total prej **500,000 EUR**.
  - b) **“Zhvillimi i një sistemi inovativ për trajtimin e mbetjeve spitalore”**, në partneritet me: Universitetin e Janinës, Rajonin e Decentralizuar të Epirit dhe Maqedonisë Perëndimore, Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë dhe Spitalin Rajonal Vlorë, me një buxhet total prej **900.000EUR**.
  - c) **“Krijimi i një rrjeti për promovim, mbrojtje dhe zhvillim të qëndrueshëm të sistemit detar dhe bregdetar në portin dhe gjirin e Vlorës”**, në partneritet me: Universitetin e Janinës, Rajonin e Decentralizuar të Epirit dhe Maqedonisë Perëndimore, Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë dhe Portin e Vlorës, me një buxhet total prej **700.000EUR**.
  - d) **“Krijimi i një sistemi monitorues për mbikëqyrjen e ndotjes të shkaktuar nga aktivitetet humane dhe ato bregdetare”**, në partneritet me: Universitetin e Janinës, Rajonin e Decentralizuar të Epirit dhe Maqedonisë Perëndimore, Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë dhe Qendrën mjedisore “Adriatiku”, Vlorë, me një buxhet total prej **500.000EUR**.
  - e) **“Menaxhimi eficient i mbetjeve të hoteleve kateringut në zonat turistike”**, në partneritet me Universitetin Jonian, Bashkinë e Korfuzit, Universitetin Kombëtar Teknik të Athinës dhe bashkisë Sarandë dhe Himarë, me një buxhet total prej **1,000.000EUR**.